



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2, pika c të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, qershor 2008), nenit 33, paragrafi 33.1, pika c dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më, 28.12.2022 merr këtë :

V E N D I M

**PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E VENDIMIT PËR
HAPJEN E KODIT BUXHETOR**

I.

MIRATOHET Vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për hapjen e kodit buxhetor për regjistrim të mjeteve të participimit prej 20 % të fermerëve, sipas projektit "*Furnizimi dhe montimi i serrave*", me nr. 01-400/01-177472/22, i dt. 26.07.2022.

II.

Sipas pikës I të këtij vendimi, plotësim-ndryshimi nënkupton përfshirjen e vlerës totale të projektit, e cila është 138,661.70€. me 80% të kësaj shume do të participojë komuna apo 104,754.02€, dhe 20% apo 33,907.68€, do të jetë participim nga bujqit përfitues të këtij projekti.

III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtorja e Financave.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-400/01-277033/22, më 29.12.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

